



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit
Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.**

Datë 04/06//2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lënda: Projekt vendim për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës”.

Analiza ligjore: Këshilli Bashkiak Vau Dejës, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligji 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025. Shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.2174/1 datë 09.04.2025 “Njoftim për shpalljen fituse të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për objekte shkollore dhe sportive të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin”, protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/2 datë 14.04.2025, Shkresës Nr prot 3196 datë 22.05.2025 “Për realizimin e projekteve me cikël financiar 2025-2026, protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/4 datë 26.05.2025,

Situata aktuale e funksionit: Ky projekt vendim ka për qëllim përmirësimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 “Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës” dhe Shprehjes Ligjshmerisë nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025, duke plotësuar nevojat e Bashkisë Vau Dejës. Ministria e Arsimit dhe Sportit, me shkresën nr.2174/1 datë 09.04.2025 “Njoftim për shpalljen fitues të projekteve të aplikuara pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për objektet shkollore të arsimit parauniversitar dhe programit për sportin”, protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/3 datë 14.04.2025, ka vënë në dijeni Bashkinë për miratimin e financimit të projektit “Rikonstruktiv i shkollës 9-vjeçare dhe e mesme + shtesë 2 kat Bushat”, dhe me Shkresën Nr prot 3196 datë 22.05.2025 “Për realizimin e projekteve me cikël financimi 2025-2026”, protokolluar nga Bashkia Vau Dejës me nr prot 799/4 datë 26.05.2025, ka vijuar me transmetimin e informacionit të tjera përkatëse. Bashkia Vau Dejës është e angazhuar në bashkëfinancimin e këtij projekti në masën 15% të vlerës totale të tij, dhe vlera e bashkëfinancimit nga ana e Bashkisë me fondet e veta është për vitin 2025 në masën 4.376.857 lek, dhe për vitet 2026-2027 17.507.428 lek. Total vlerë bashkëfinancimi nga



NJQV është 21.884.285 lek. Në kuadër të kësaj vlere bashkëfinancimi, është e nevojshme që keto vlera të jene të disponueshme në programin 09120.

Situata financiare :

Buxheti i Bashkisë miratuar sipas VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 të shtohet zëri i Projektit "Mbikqyrje dhe kolaudim i projektit" rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare dhe e mesme + shtesë 2 kat Bushat" program ky në të cilin është transferuar edhe vlera e financimit nga ana e ministrisë. Kjo vlera do të shpërndahet në tre vite 2025-2027 në këtë program.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Projekt vendimi impakton kushtet e nxënësve të Njesisë Administrative Bushat.

Komisioni i Përhershëm për "Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare", i mbledhur me datën 25/04/2025, shqyrtoi projekt vendimin, relacionin dhe dokumentet shoqëruese në lidhje me propozimin për ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës".


Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash:

VENDOSI

T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

1. Të miratojë ndryshimin e Vkb nr.84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe PBA Përfundimtare 2025-2027 dhe numrin e punonjesve të Bashkisë Vau Dejës" sipas projekt vendimit të paraqitur.

 **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

 **Zv. Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit